

DEKLARATË

Ministria e Brendshme të miratojë e publikojë sa më parë udhëzimin për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për Zgjedhjet e 11 majit 2025

Lista e zgjedhësve është një ndër elementët thelbësorë të përgatitjes së një procesi zgjedhor, pasi siguron drejtpërdrejt të drejtën kushtetuese të votës për çdo shtetas shqiptar, i cili mbush 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve. Kodi Zgjedhor përcakton se hartimi i listës finale të zgjedhësve kalon në një proces hartimi, verifikimi dhe publikimi përgjatë së cilës të gjithë shtetasit shqiptarë të mund të sigurohen për përfshirjen në mënyrë të saktë të të dhënave të tyre në listë.

Publikimi i listave paraprake apo siç quhet, publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, realizohet nëpërmjet një procesi në të cilin përfshihen Ministri i Brendshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), Bashkitë, si dhe Zyrat e Gjendjes Civile (ZGJC) pranë çdo bashkie, ndërkohë që i gjithë procesi mbikqyret nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Zgjedhjet Parlamentare të 11 majit 2025, të dekretuara më datën 5 dhjetor 2024, japin mundësinë e publikimit të 3 ekstrakteve¹ të përbërësve zgjedhorë.

Sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, **fillimi i procesit të hartimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo Zyre të Gjendjes Civile, duhet të fillonte prej ZGJC-ve jo më vonë se ditën e djeshme, datë 10 dhjetor 2024**, bazuar në një Udhëzim të Ministrit të Brendshëm, i cili ende nuk është miratuar² e bërë me dije.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) shpreh shqetësimin e tij për mos miratimin ende prej Ministrit të Brendshëm të Udhëzimit mbi procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

KRIIK ka shprehur edhe më parë shqetësimin se për këtë proces zgjedhor mbetet shumë pak kohë për procesin e verifikimit dhe pastrimit të listave të zgjedhësve duke qenë se do të publikohen vetëm tre ekstrakte të përbërësve zgjedhorë³, kohë e pamjaftueshme në gjykimin e KRIIK, për kontrollin dhe saktësimin e listave të zgjedhësve **nisur nga problematikat e shumta të mbartura nga proceset e mëparshme zgjedhore⁴, e sidomos ato të zgjedhjeve vendore 2023.**

Nga ana tjetër, mundësitë për të adresuar saktësimin e përbërësve zgjedhorë zvogëlohen edhe më nëse do të merret në konsideratë se Kodi Zgjedhor parashikon se kërkesat për ndryshime në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë mund të paraqiten në ZGJC jo më vonë se data 11 mars 2025. Po ashtu, vështirësohet mjaft mundësia e saktësimit të përbërësve

¹ Bazuar në parashikimet e neneve 51 dhe 56 të Kodit Zgjedhor, datat e publikimit të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë janë 4 janar 2025, 3 shkurt 2025 dhe 5 mars 2025. Ndërsa lista përfundimtare e zgjedhësve publikohet më datën 1 Prill 2025.

² KRIIK në pamundësi të kontaktimit dhe marrjes së informacionit prej Ministrisë së Brendshme, mori informacion verbal prej Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe disa prej bashkive të vendit.

³ Shih për më shumë Deklaratën e KRIIK: [“Dekretimi sa më parë i Datës së Zgjedhjeve, domosdoshmëri për të mos vënë nën stres procesin përgatitor dhe atë ligjzbatues në Procesin Zgjedhor për Kuvendin të vitit 2025”](#), publikuar më 3.12.2024.

⁴ Shih për më shumë Qëndrimin Publik të KRIIK: [“Ministria e Brendshme të bëjë transparencë të plotë, në mënyrë periodike, mbi tërë procesin e hartimit dhe saktësimit të listës së zgjedhësve”](#), publikuar më 5.10.2020.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

zgjedorë për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë, pasi procedura e aplikimit të tyre për tu bërë pjesë e listës së zgjedhësve jashtë vendit fillon më datën 11 janar e përfundon më datën 11 mars 2025 (*neni 25, pika 4 e Kodit Zgjedor*).

Lidhur me gjithë sa më sipër, **KRIIK i bën thirrje Ministrit të Brendshëm që të miratojë sa më parë Udhëzimin** mbi procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për Zgjedhjet Parlamentare të 11 majit 2025, duke marrë në konsideratë edhe adresimin e shqetësimeve të vërejtura më parë nga raportet e auditëve teknikienë, si dhe gjetjet e rekomandimet lidhur me këtë proces të vëzhguesve të zgjedhjeve.

Në hartim të këtij Udhëzimi dhe ndjekje të këtij procesi, **KRIIK sjell publikisht në vëmendje të Ministrit të Brendshëm që të marrë në konsideratë:**

- Citimin eksplicit në udhëzim të shprehjes “... gjenerimin automatik të listës nga sistemi i RKGJC-së”, sikurse ishte përcaktuar në udhëzimet e tilla të mëparshme, duke evituar dhe **mos lënë asnjë hapësirë për menaxhimin manual të tij**;
- Përbushjen e plotë të detyrimeve ligjore që rrjedhin prej Kodit Zgjedor lidhur me **procesin e njoftimit me shkrim të zgjedhësve dhe mekanizmin e llogaridhënies** së Kryetarëve të Bashkive për këtë proces (*neni 52, pika 4 e Kodit Zgjedor*);
- **Parashikimin e fondit financiar të nevojshëm** për njoftimin me shkrim të zgjedhësve, **i cili duhet vënë në dispozicion të çdo Bashkie përpara datës 4 janar 2025**, kohë në të cilën nis periudha 60 ditore e njoftimit me shkrim ndaj çdo zgjedhësi që banon në territorin e bashkisë përkatëse (*neni 52, pika 1 dhe 5 e Kodit Zgjedor*);
- **parashikimin në udhëzim të modelit të duhur të njoftimit** që do të përdoret për njoftimin me shkrim të zgjedhësve, **i cili duhet të përmbajë vendin ku duhet të firmosë shtetasi apo anëtar i familjes** që njoftohet (*neni 52, pika 4 e Kodit Zgjedor*);

Në përfundim, **KRIIK i bën thirrje dhe nxit Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile që të angazhohen dhe të bëjnë transparencë të plotë në mënyrë periodike përgjatë gjithë këtij procesi.**

Kjo transparencë është akoma më shumë e dosmosdoshme në këtë proces zgjedhor, pasi për herë të parë do të aplikohet votimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë, e për rrjedhim do të bëhet heqja e atyre që shprehin kërkesë nga lista e zgjedhësve brenda vendit.

Gjithashtu është e domosdoshme që, minimalisht pas çdo publikimi të ekstraktit zgjedhor, të bëhet një paraqitje e plotë e tërë procesit të ndjekur si dhe të bëhet publikimi i të gjithë të dhënave përmbledhëse të ekstraktit përkatës.

KRIIK i bën thirrje dhe nxit Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe NënKomisionerin, që të bëjnë sa më parë emërimin e dy auditëve teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGjC-së, emërimi i të cilëve duhet të bëhet jo më vonë se data 4 janar 2025 (*neni 61, pika 2 e Kodit Zgjedor*).

Gjithashtu, **KRIIK i bën thirrje dhe nxit Kuvendin e Shqipërisë që të përmbushë detyrimet e tij duke i dhënë legjitimitet të plotë mandatit të NënKomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**, duke e ri-zgjedhur NënKomisionerin në detyrë apo zgjedhur një të ri, pasi ky mandat ka përfunduar më datën 5 tetor 2024.

Tiranë, më 11 Dhjetor 2024!